



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry
Departamenti i Rregullimit të Tregut të Naftës

FTESË PUBLIKE

Njoftohen të gjitha palët e interesuara (Operatori Ekonomik për pastrimin e rezervuarëve për derivate të lëngëta të naftës) se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Departamenti i Rregullimit të Tregut të Naftës, kërkon të autorizojë:

1. Operatorë ekonomik për pastrimin e rezervuarëve për derivate të lëngëta të naftës;
2. Në zbatim të Ligjit Nr.2004/5 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-138 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.06/2019 për kushtet teknike për import, deponim, shitje me shumicë dhe pakicë të karburanteve të lëngëta të naftës dhe pastrim të rezervuarëve;
3. Operatori ekonomik për pastrimin e rezervuarëve për derivate të lëngëta të naftës në zbatim të legjislacionit në fuqi duhet të ketë pëlqimin nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit bazuar në kërkesat e standardit ISO14001/2004, të ketë certifikatë nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave bazuar në standardin ISO 18001 mbi menaxhimin e mbrojtjes dhe shëndetit në punë.
4. Operatorët ekonomik për pastrimin e rezervuarëve për derivate të lëngëta të naftës të cilat aplikojnë për autorizim duhet të bashkëngjisin në aplikacion të gjitha dokumentet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr.06/2019 dhe dokumentet e lartcekura;
5. Formulari i aplikimit i cili merret në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë duhet të ketë këtë përmbajtje:
 - 5.1.Certifikata e regjistrimit të biznesit me të dhënat mbi biznesin, ku ceket dhe veprimtaria me shifër 4671 dhe informata tjera për pronarin apo menaxherin;
 - 5.2.Certifikata e TVSH-së nëse aplikohet;
 - 5.3.Vërtetimi se i ka përmbushur obligimet tatimore mbi të ardhurat;
 - 5.4.Vërtetimin se firma nuk është në falimentim apo administrim të dhunshëm gjyqësor;
 - 5.5.Planin e detajuar teknik dhe narrativ të metodologjisë së pastrimit të rezervuarëve;
 - 5.6.Dëshmitë mbi pronësinë e pajisjeve të prezantuara për pastrimin e rezervuarëve ose dëshmitë ekuivalente për të drejtën e posedimit të pajisjeve të tilla, gjatë tërë kohës në Republikën e Kosovës;
 - 5.7.Kopjet e certifikatave dhe dokumenteve tjera të lartcekura, si dhe të gjithë dokumentet tjerë që janë të renditura në Udhëzimin Administrativ 06/2019, duhet të jenë kopje të vërtetuara tek noteri.
6. Dokumentacionit duhet t'i bashkëngjitet edhe lista e çmimeve, e specifikuar për kapacitetin e rezervuarëve si mbitokësor ashtu edhe të atyre nëntokësor;

7. Ftesa publike është e hapur 15 ditë pune pas ditës së publikimit.

Aktet e lartcekura mund t'i gjeni në ueb-faqe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në arkivin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Për çdo paqartësi, operatorët ekonomik që aplikojnë për autorizim në kompetencën e fushës së lartcekur, mund të vijnë paraprakisht të konsultohen në Departamentin e Rregullimit të Tregut të Naftës rreth kompletimit të dosjes para se lënda të dorëzohet në arkivë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Adresa:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti i Rregullimit të Tregut të Naftës

Tel: 038 200 36 551/531